

HYLLI I DRITËS

Ubi Spiritus Domini, ibi libertas
(II. ad Cor. III. 17).

VOTER
KULTURE
SHQYPTARE

318 B
A
1-19
1-3

Kalinduer-Marc 1943-XXI.

VJETI XIX.

S H K O D E R

Pajtimi per të perkohshmen „HYLLI I DRITËS“

Shqypni	Nji numer Fr. 1.50	Nji vjetë Fr. 15.—
Itali	» » » 1.50	» » » 15.—
Nder vende tjera . . .	» » » 2.—	» » » 20.—

Themelue në vjetin 1913 prej At Gjergj Fishtës

PERMBAJTJA

P. MARIN SIRDANI — Kulturë e arte në Shqipni	FAOB	1
Dr. V. SAMIM VISOKA — Arësimi i Katundarëve		8
VITTORE PISANI — Rreth nji botimi të Prof. Dr. G. Stadtmüller mbi historin e hershme shqyptare		20
MELIBEU — Pësë Máj		23
GJUSH SHELDIJA — Shiroka e gjuetija e peshkut në liqë të Shkodres e në lumin Buenë, Drī e Kir		26
BARDHYLI — Historija e Bibliotekave në Shqipërië		35
EPRI — Matutini		46
DON PREND SULI — Nierzit e kanús		54
D. ALEKSANDER SIRDANI — Frazheologí		63
A. RROK GURASHI — Dokumenta të pabotuem		68
GELASIUS — Bindimi i Diellit ndër Illyrë		77
GJUSH SHELDIJA — Deka e Dezdar Osman Agës		85
INJAC GJ. NDOJAJ — Pasunija private e Shqipnis		88
VA — KUNDRIME LETRARE		95
A. D. KURTI — Prralla. — Blë. II. Fash. 14, 15.		

HYLLI I DRITËS

EPERKOHËSHME KULTURALE-LETRARE

Kulturë e arte në Shqipni

Shqipnija tue kjenë ndermjet dy qendrave kulturore — Atinë e Romë —, ásht, posë Greçis, vendi mâ i pasuni per kujtime në gadishllin e Ballkanit. Per ket «regio mirabilissima», si e thurret Thallóczy Shqipnín ¹⁾, na flasin shkrimtarë të hershem Erodoti, Omeri, Polibi, Plini etj, e tepricat monumentare, të cilat edhe sod soditen, e dishmojn kulturen e qytetnín e dikurshme të saj. E me të vertetë se tue udhtue neper Shqipni shihen jo pak teprica qytetesh së vjetra, rrënime monumentash, epigrafe vorresash, trupore etj. qi perkujtojn gjêjen kulturore në të cilen mbërriti ky vend në kohë të ndryshme. Ká, mandej, edhe shum vende, posë atyne të germuemeve, në gjí të cilave mbulohen ndertesa, monumenta, trupore e material gjithfaret qi nji dishdite neper veper t' arkeologut, kanë me u dhanë breznive të reja sa faqe t' interesantshme historiye. Sa per tash, edhe pse kazmja e disa arkeologjve tedeshkë, italianë e francezë provoi aty-këtu të zbuloj vjetersít shqiptare, mund të thuehet se pergjithsisht dokumentat e historís së Shqipnís së hershme janë endë mbulue prej dheut. Rrethanat e ndryshme politikore të cilat disa herë, në rrymen e shekujve, i prún rrënim të plotë këtij vendi, bán qi të zhdukej prej faqes së tokës shka të mbarë e të mirë punoi dore e nierit.

Per dijetarët e studjozët, Shqipnija, ásht endë në lamën gjeologjike, glosologjike, soçilogjike, antropologjike nji pyllë

¹⁾ — Thallóczy «Acta et Diplomata», V. I, Prolegomena.

Arp / 850

